



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

---

Numri i lëndës: 2019:269288  
Datë: 14.01.2020  
Numri i dokumentit: 00759455

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, me gjyqtarin Krenar Berisha, dhe sekretaren juridike Nazife Sheholli, në konfliktin administrativ të paditësit [“K...”] nga Podujeva kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës në Prishtinë, me bazë juridike: vlersim tatimor, në seancën e shqyrtimit kryesor të mbajtur me datën 14.01.2020, në prani të autorizuarit të palës paditëse, e në mungesë të palës së paditur, mori këtë:

A K T V E N D I M

HUDHET poshtë si e palejshme padia e paditësit [“K...”] nga Podujeva, në këtë konflikt administrativ të evidentuar me nr.A.1003/18, për shkak se nuk ekziston interesi juridik i paditësit për vazhdimin e procedurës në konflikt administrativ

A R S Y E T I M

Me Aktgjykimin AA.nr.216/2014 dt.12.04.2018 Gjykata e Apelit të Kosovës ka aprovuar padin e paditësit ATK-së të ushtruar kundër të paditures BPR, për anulimin e aktvendimit A.nr.217/2006 dt.10.04.2014, dhe lëndën e ka kthyer në rigjykim dhe rivendosje tek Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për çështje administrative-Divizioni Fiskal.

Gjykata ka shqyrtuar këtë konflikt administrativ gjyqësor konform dispozitave të nenit 41 të LKA-së, për arsye se pala e paditur me parashtrësën e datës 27.12.2019 ka njoftuar gjykatën se nuk mund të prezantoj në seancën gjyqësore

Gjykata duke vepruar sipas vërejtjeve të Aktgjykimit të Apelit, mungesës së palës së paditur në seancën e shqyrtimit kryesor, provave në lëndë, deklarimeve në seancë, pasi ka shqyrtuar lejueshmërinë e kërkesëpadisë së paditësit kundër vendimit nr.05/2006 të datës 07.03.2006 i D.A.-ATK-së, ka konstatuar se nuk ekziston interesi juridik i paditësit për vazhdimin e procedurës në konflikt administrativ.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të mbajtur me datën 14.01.2020, përfaqësuesi i autorizuar i paditësit ka deklaruar se nuk kemi asnjë obligim pagese ndaj të paditurës , prandaj nuk kemi interes juridik për vazhdimin e procedurës në këtë konflikt administrativ në gjykat.

Gjykata nga shkresat e lëndës, dhe deklarimeve në seancën e shqyrtimit kryesor, konstaton se nuk ka mundur të vendos lidhur me themelësinë e ankesës-padisë dhe ligjshmërinë e aktit administrativ të paditures ATK-së nr.05/2006 datës 07.03.2006, pasi që në rastin konkret paditësi nuk ka interes juridik që të zhvillohet ky konflikt administrativ.

Në bazë të arsyeve të lartcekura, e në kuptim të dispozitave të nenit 81.C të Ligjit nr.04/L-102 dhe nenit 391 par.(e) të Ligjit për Procedurën Kontestimore 03/L-006, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË  
A.nr.1003/18 dt.14.01.2020

G j y q t a r i  
Krenar Berisha

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktvendimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.